

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6446
E premte, 22 tetor 2021
çmimi 0.40 €

Anulohen zgjedhjet në Han të Elezit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

BE-ja DHE OPOZITA KUNDËRSHTOJNË VETINGUN E PROPOZUAR NGA QEVERIA



Bashkimi Evropian dhe opozita kanë kundërshtuar modelin e vetingut në fushën e drejtësisë të propozuar nga Qeveria e Kosovës. Përfaqësuesit e partive opozitare kanë thënë se kundërshtimi i këtij procesi nga BE-ja dëshmon paaftësinë e qeverisë Kurti për ta realizuar një proces kaq të rëndësishëm. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka theksuar se, pavarësisht prej kritikave, ky proces do të vazhdojë

KOSOVA RRIT NUMRIN E PJESËTARËVE TË FSK-së



KRIJIMI I GJYKATËS KOMERCIALE, NDIHMESË E MADHE PËR OPERIMIN E BIZNESEVE TË VOGLA

FAQE 7

OPINION

REZULTATET E ZGJEDHJEVE LOKALE APO FURTUNË PARA QETËSISË!

F. 6

Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA



AKTUALE



OBSH-ja PARALAJMËRON SE PANDEMIA DO TË ZGJASË EDHE GJATË VITIT 2022

F. 2

BRENDA NËNTË MUAJVE NË PEDIATRI JANË REALIZUAR 22 MIJË KONTROLLE MJEKËSORE

F. 3

EKONOMI



BANKA BOTËRORE: KOSOVA DUHET TË PËRQENDROHET NË KRIJIMIN E VENDEVE TË PUNËS

F. 8

SPORT



DACI: NDJENJË E VEÇANTË TË LUAJ NË ELITËN E BASKETBOLLIT NË TURQI

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepgjsh - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSH-ja paralajmëron se pandemia do të zgjasë edhe gjatë vitit 2022



GENEVË, 21 TETOR - Pandemia e Covid-19 do të vazhdojë edhe për një vit më shumë sesa do të duhej pasi vendet e varfra nuk po furnizohen me vaksinat kundër koronavirusit, ka njoftuar Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH).

Drejtuuesi i lartë i OBSH-së, Bruce Aylward, ka thënë se situata në vendet e varfra jep sinjale se kriza e pandemisë mund të vazhdojë edhe në vitin 2022.

Më pak se 5 për qind e popullsisë së Afrikës është vaksinuar,

krahasuar me 40 për qind në shumicën e kontinenteve të tjera. Aylward u bëri thirrje vendeve të pasura që të heqin dorë nga porositi e vaksinave në mënyrë që kompanitë farmaceutike të mund t'u japin përparësi vendeve me të ardhura më të ulëta. "Mund t'ju them se nuk jemi në rrugën e duhur. Ne me të vërtetë duhet ta përshtojmë (vaksinimin) ose e dini çfarë? Kjo pandemi do të vazhdojë për një vit më shumë sesa duhet", ka thënë ai. Covax, një program global për

shpërndarjen e vaksinave në vendet e varfra i udhëhequr bashkërisht nga aleanca e vaksinave GAVI dhe OBSH-ja, synonte të dhuronte dy miliardë doza vaksinash deri në fund të këtij viti, por deri tani ka dërguar 371 milionë doza.

Në fillim të shtatorit grupi i 20 vendeve më të pasura të botës, i njohur si G20, ka rënë dakord për t'i rritur përpjekjet që t'i ndihmojnë vendet e varfra ta vaksinonjë popullsinë e tyre kundër Covid-19.

Trumpi hap rrjet social

WASHINGTON, 21 TETOR - Ish-presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka njoftuar për planet për të lëshuar në përdorim aplikacionin e tij të mediave sociale.

Llogaritë e Trumpit janë të ndaluara nga "Twitter" dhe "Facebook". "Rrjeti i mediave sociale të Trumpit do të quhet 'Truth Social' dhe do të fillojë së funksionuari në muajin nëntor për një numër të caktuar njerëzish, pastaj vitin e ardhshëm do të fillojë shpërndarja mbarëkombëtare", ka njoftuar Trump Media&Technology

Group (TMTG) në një deklaratë për media, duke shtuar se "Truth Social" synon të rivalizojë kompanitë e mëdha teknologjike, të tilla si "Twitter" dhe "Facebook". "Ne jetojmë në një botë ku talebanët kanë një prani të madhe në 'Twitter', megjithatë presidenti juaj i preferuar amerikan është heshtur. Kjo është e papranueshme", thuhet në deklaratë.

Llogaritë e ish-presidentit Trump u ndaluan nga "Twitter"-i, "Facebook"-u dhe disa rrjete të tjera pas sulmit në Kongresin

amerikan më 6 janar nga mbështetësit e tij, të cilët synuan ta ndalonin certifikimin e fitores së Joe Bidenit në zgjedhjet e 3 nëntorit.

Në arsyetimin e tyre për ta ndaluar Trumpin, platformat e mediave sociale përmendën rrezikun e dhunës. Që nga ndalimi Trumpi përmes mënyrave të ndryshme ka synuar për ta rifituar praninë e tij në mediat sociale. Ai kishte 88 milionë ndjekës në "Twitter" dhe e ka përdorur shumë këtë rrjet social për të komunikuar me ndjekësit e tij.



Vaksina "Pfizeri", shumë efektive te grupmosha 12-18 vjeç, thotë hulumtimi

NJU-JORK, 21 TETOR - Vaksina kundër koronavirusit e kompanisë Pfizer/BioNTech është shumë efektive për parandalimin e infeksionit dhe simptomave të sëmundjes nga varianti 'Delta' te të rinjtë e moshës 12 deri në 18 vjeç, thuhet në një hulumtim të kryer në Izrael.

Rezultatet e hulumtimit të botuara në "New England Journal of Medicine", mbase do të ofrojnë më shumë siguri se



vaksina është efektive kundër variantit te të rinjtë derisa Agjencia Federale e Barnave (FDA) në Shtetet e Bashkuara po

shqyrton autorizimin e përdorimit të vaksinës te fëmijët e moshës pesë vjeç.

Hulumtimi tregoi rezultate se efektiviteti i vaksinës kundër infeksionit të Covid-19 tek adoleshentët ishte 90 për qind dhe 93 për qind kundër simptomave të Covid-19 në ditën e shtatë deri në 21 pas dozës së dytë.

Organizata izraelite për shëndetin Clalit dhe studiuesit e Universitetit të Harvardit

rishikuan të dhënat nga 94 354 persona të moshën 12 deri në 18 vjeç që kishin marrë vaksinën të cilat u krahasuan me një numër identik të adoleshentëve të pavaksinuar nga e njëjta grupmoshë.

Hulumtimi u krye midis qershorit dhe shtatorit, kur varianti "Delta" dominonte rastet në Izrael.

Në fillim të kësaj jave një analizë e publikuar nga ana e Qendrave për Kontrollin dhe Parandalimin

e Sëmundjeve (CDC) në ShBA u tha se vaksina "Pfizer/BioNTech" ishte 93 për qind efektive për parandalimin e shtrimeve në spital te personat e moshës 12 deri në 18 vjeç.

Vaksina "Pfizer/BioNTech" është e autorizuar për fëmijët e moshës 12 vjeç e lart dhe kompanitë po kërkojnë miratim të mëtejshëm nga Administrata e Ushqimit dhe Barnave për përdorim te fëmijët që janë pesë vjeç.

Shefi i NATO-s kritikon reagimin e Rosisë ndaj dëbimit të diplomatëve

BRUKSEL, 21 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se i vjen keq për vendimin e Rosisë që ta ndalojë punën e zyrës së aleancës në Moskë. Duke folur në një konferencë për media në Bruksel, Stoltenberg ka thënë se kjo masë nuk shërben për ta promovuar dialogun ose mirëkuptimin reciprok. "Sidoqoftë, NATO do të mbetet e hapur për dialog, drejtpërdrejt ose

përmes Këshillit NATO-Rusi", ka deklaruar Stoltenberg. Komentet vijnë pasi Moskë ka bërë me dije se do ta pezullojë punën e misionit të saj në selinë e NATO-s në Bruksel, nisur nga fillimi i nëntorit. Përveç kësaj, edhe misioni ushtarak i NATO-s në Moskë nuk do të lejohet ta vazhdojë punën e tij.

Ky reagim i Moskës erdhi pasi NATO-ja ka njoftuar se u ka tërhequr akreditimin tetë



diplomatëve rusë në Bruksel, nën pretendimet se ata kanë

qenë "oficerë të padeklaruar të inteligjencës".

NATO, po ashtu, tha se delegacioni i Moskës në aleancë do të përgjysmohet nga 20 veta në 10.

Stoltenbergu ka thënë se vendimi i NATO-s për t'i tërhequr akreditimet është bazuar në gjetjet e inteligjencës dhe shtoi se diplomatët në fjalë ishin operativë të inteligjencës ruse. "Aleatët kanë shprehur

shqetësim të madh për këto lloje të aktiviteteve malinje që kemi parë vitet e fundit", ka deklaruar Stoltenberg.

Si shembuj, Stoltenberg ka përmendur përpjekjen e dështuar për grushtshtet në Mal të Zi në vitin 2016, sulmin me agent nervor në qytetin Sallsbëri të Anglisë në vitin 2018 dhe përpjekjen për piraterim të Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike në po të njëjtin vit.

Kosova rrit numrin e pjesëtarëve të FSK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 TETOR - Kosova do ta rrisë numrin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) për 840, kështu ka thënë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, në një konferencë për media në Prishtinë.

Ai ka thënë se konkursi është i hapur që nga dita e enjte. "Ftoj të gjitha komunitetet që dëshirojnë të jenë pjesë e Forcës së Sigurisë të bashkëngjiten", ka thënë Mehaj, duke premtuar një proces transparent të përzgjedhjes së rekrutëve të rinj.

FSK-ja numëron përafërsisht 2 500 anëtarë të rregullt dhe 800 rezervistë.

Në dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet ligjore, për ta ndryshuar mandatin e FSK-së. Kësaj force është thënë se do t'i nevojitet një periudhë kohore prej dhjetë vjetësh për t'u transformuar në ushtri me kapacitete të plota.

Me planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, planifikohet që

numri i pjesëtarëve të FSK-së të arrijë në 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 2 500 rezervë.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, tha se gjatë vitit të ardhshëm do të ketë rezultate konkrete nga bashkëpunimi për blerjen e armatimit nga Shtetet e Bashkuara. Ai këto komente i bëri pas një vizite disaditore që ka zhvilluar në Shtetet e Bashkuara. Në muajin qershor Qeveria e Kosovës ka shqyrtuar propozimin për blerjen e dronëve nga Shtetet e Bashkuara për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Edhe dronët janë pjesë e FMS-së (Programit për shitjen e huaj të armatimit të ShBA-së). Vitin e ardhshëm do të shihni edhe për pajisje të tjera", ka thënë Mehaj, duke shtuar se nga zyrtarët e Shteteve të Bashkuara ka marrë mbështetje për zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ai ka thënë se ShBA-ja dhe Kosova janë pajtuar për ta thelluar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, pastaj partneritetin me Gardën



Kombëtare të Iowas dhe mbrojtjen kibernetike.

Kosova, në bashkëpunim me forcat amerikane, dërgoi në mars në Kuvajt një kontingjent të FSK-së që është misioni i parë jashtë

vendit i kësaj force.

Mehaj ka theksuar se janë në bisedime edhe për bashkëzbatim të tjera, përfshirë Poloninë dhe vendet e tjera, por nuk dha më shumë hollësi.

Koordinimi në mes të ShBA-së dhe Kosovës do të vazhdojë edhe në lidhje me propozimin që ai ua bëri autoriteteve amerikane për të hapur një bazë të përhershme ushtarake në Kosovë.

Brenda nëntë muajve në Pediatri janë realizuar 22 mijë kontrole mjekësore



PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Mes përbaljes me pandeminë, vështirësive të përditshme dhe sfidave pa mbarim, Klinika e Pediatri në Qendrën Klinike Universitare, gjatë nëntë muajve të vitit 2021, ka ofruar shumë shërbime mjekësore për fëmijët e sëmurë. Ndonëse në pjesën më të madhe të këtyre muajve, disa reparte të saj ishin të ngarkuar me pacientë të

prekur me Covid, duke respektuar masat kundër Covidit, Pediatria nuk i ka ndalur asnjëherë shërbimet e tjera dhe brenda periudhës janar-shtator janë realizuar më tepër se 22 mijë kontrole.

Raporti i punës thotë se deri në fund të muajit të shkuar numri i vizitave në ambulancat specialiste ka mbërritur në 13 301, janë bërë 5 397 pranime,

651 EKG, 1 582 ECHO të zemrës, 1 861 ECHO të abdomenit, 82 ECHO të gjëndrës tiroide, 7 spirometri, janë ofruar 38 shërbime të Floctometrisë dhe janë realizuar 72 punksi.

Brenda kësaj kohe janë realizuar, gjithashtu, 951 EEG, 1 582 ECHO të trurit, 1 861 ECHO të mushkërive, 1 222 strisho gjenetike dhe 6 285 analiza gazore.

SBASHK-u i kërkon ministres Nagavci normalizimin e procesit mësimor

PRISHTINË, 21 TETOR - Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, për t'ia përcjellë kërkesën e mësimdhënësve që pas situatës shumë më të qetë me pandeminë, të normalizohet në tërësi procesi mësimor.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, dhe koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, i kanë paraqitur këtë kërkesë ministres Nagavci duke e argumentuar me faktin se situata me pandeminë është përmirësuar dukshëm dhe se janë krijuar kushtet që arsimit në Kosovë t'i kthehet në tërësi normaliteti, duke nënkuptuar që paralelet e ndara në grupe të bashkohen

prapë dhe orët mësimore të jenë në kohëzgjatjen e duhur.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë treguar në këtë takim se edhe Shqipëria, Maqedonia e Veriut e shtete të tjera e kanë normalizuar në tërësi procesin mësimor duke vazhduar me respektimin e masave mbrojtëse.

Ministrja Nagavci është shprehur se edhe ajo ka qëndrim të njëjtë lidhur me këtë çështje, prandaj përkrah këtë propozim dhe se në takimet dhe komunikimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera gjegjëse do të kërkojë që të aprovohet ky propozim me qëllim që në kohën më të shkurtër të mundshme të merret vendimi për normalizimin e plotë të procesit mësimor.





BE-ja dhe opozita kundërshtojnë vetingun e propozuar nga qeveria

Bashkimi Evropian dhe opozita kanë kundërshtuar modelin e vetingut në fushën e drejtësisë të propozuar nga Qeveria e Kosovës. Përfaqësuesit e partive opozitare kanë thënë se kundërshtimi i këtij procesi nga BE-ja dëshmon paaftësinë e qeverisë Kurti për ta realizuar një proces kaq të rëndësishëm. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka theksuar se, pavarësisht prej kritikave, ky proces do të vazhdojë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 TETOR - Pas Komisionit Evropian, edhe subjektet opozitare e kanë kundërshtuar modelin e vetingut në drejtësi të propozuar nga qeveria Kurti. Përfaqësuesit e partive opozitare kanë deklaruar se kundërshtimi i këtij procesi nga BE-ja dëshmon paaftësinë e qeverisë për ta realizuar një proces të tillë.

Ish-ministri i Drejtësisë, Ablerad Tahiri, ka vlerësuar se para këtij procesi duhet të vihen në jetë të gjitha instancat e tjera pararendëse që sigurojnë

integritet dhe llogaridhënie. “Konstatimi se të gjithë mekanizmat e tjerë institucionalë janë të dështuar, për çfarë vetingu është domosdoshmëri, është jo vetëm konstatim i pasaktë, por edhe i turpshëm dhe dëm i madh në pasqyrimin e realitetit të vendit në krye të të cilit, ajo e mban pozitën e presidentes. Pak muaj u deshën për ta parë qartë dështimin e mazhorancës së Vjosës dhe Albinit që të sjellin ide konkrete e të qëndrueshme për vetingun, gjë që dëshmon paaftësinë e tyre për ta realizuar një proces të tillë”, ka shkruar Tahiri në profilin e vet në

“Facebook”.

Ai ka treguar se para se të ndodhë ky proces duhet të kryhen disa veprime. “Bashkimi Evropian, siç edhe partnerët e tjerë strategjikë që kanë ndihmuar Kosovën në këtë sektor, asnjëherë nuk kanë konstatuar se vetingu nuk duhet të ndodhë. Por, para se një i tillë të vijë në shprehje, e për çfarë qeveria aktuale nuk ka as ide, as dije dhe as formulë, duhet fillimisht të vihen në jetë të gjitha instancat e tjera pararendëse që sigurojnë integritet dhe llogaridhënie. Tendencat për ta imponuar një proces të vetingut mbi bazën e paragjykitimit dhe ngarkesave ideologjike,

paralelisht me dështimin për të ofruar një model të qëndrueshëm të bazuar në ligj e kushtetutë, jo vetëm që është shpërfillje e punës dhe përpjekjeve të sistemit, por edhe një masë ideale pas së cilës është lehtë të fshihet dështimi i qeverisë në baza ditore për t'i kontribuar konsolidimit të këtij sistemi”, ka deklaruar Tahiri.

Ndaj këtij kundërshtimi ka reaguar ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Në profilin e saj në “Facebook”, ajo ka shkruar se dyshon që Tahiri e ka lexuar dokumentin e qeverisë për procesin e vetingut në drejtësi. “Ish-ministri i Drejtësisë, Tahiri, paska gjetur kohë për t'i thënë disa fjalë për vetingun dhe presidenten. Realisht kur lexon atë çfarë ka shkruar, është për keqardhje që i njëjti ka qenë ministër i Drejtësisë. Nëse lexohet koncept-dokumenti për vetingun (që

dyshoj të jetë lexuar nga Tahiri), vërehet qartë rruga që do të ndiqet për zhvillimin e procesit të vetingut, duke mundësuar një verifikim të tërësishëm të subjekteve të vetingut dhe duke ndërtuar mekanizma të cilët bëjnë verifikimin/vlerësimin e vazhdueshëm të tyre. Dhe kjo ka ardhur, pasi mekanizmat ekzistues që përmend Tahiri kanë dështuar dhe për këtë mbahet përgjegjës edhe Tahiri”, ka shkruar ajo.

Ajo ka thënë se qeveria do ta vazhdojë punën që ka nisur drejt materializimit dhe finalizimit të procesit të vetingut. “Nëse këta mekanizma llogaridhënës që përmend do të ishin efikas tash e shumë vjet, nuk do të kishim fare nevojë për veting. Në Ministri të Drejtësisë çdo ditë identifikojmë të metat e Tahirit, dhe është për keqardhje të jesh ministër i Drejtësisë dhe të mos mbahesh në mend qoftë edhe për një punë

KQZ-ja vendos të rinumërohen 23 vendvotime

PRISHTINË, 21 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që të rinumërohen 23 vendvotime të zgjedhjeve të lokale të 17 tetorit. Tetë nga vendvotimet janë për

kryetar komune, ndërsa 15 për kuvende komunale. Kryeshefi i sekretariatit të KQZ-së, Burim Ahmetaj, ka thënë se këto rinumërimet do të bëhen për shkak të parregullsive teknike dhe

mospërputhjeve të formularëve teknikë. Anëtarët e KQZ-së kanë ngritur si shqetësim anulimin e tërësishëm të disa fletëvotimeve me kusht, duke kërkuar që keqpërdorimet të dërgohen në prokurori.



të mirë. Përndryshe, ne do ta vazhdojmë punën e mirë që kemi nisur drejt materializimit dhe finalizimit të procesit të vetingut, duke ndjekur rekomandimet e këtij konceptdokumenti dhe, gjithashtu, duke bashkëpunuar me faktorin ndërkombëtar dhe të gjithë ata që e duan shtetin e së drejtës!", ka shkruar Haxhiu.

Ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se sistemi i drejtësisë duhet të fuqizohet përmes reformës, por jo me shkarje për emërime politike. "Reforma në drejtësi duhet të jetë e vazhdueshme dhe institucionale, në partneritet me ShBA-në dhe BE-në. Sistemi i drejtësisë është vlerë universale dhe çdo tendencë për shfrytëzim të të njëjtit për përfitime të brendshme partiake nuk duhet të tolerohet", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Edhe drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka vlerësuar se raporti i BE-së për Kosovën tregon se Kosova dhe BE-ja zyrtarisht qëndrojnë në pozicione të kundërta për vetingun në drejtësi. "Lajmi i parë i rëndësishëm nga raporti i sotëm i BE-së për Kosovën është se prej sot BE-ja dhe Kosova edhe zyrtarisht qëndrojnë në pozicione të kundërta sa i përket vetingut. Nga raporti: 'Qeveria e re është duke konsideruar disa

opsione për procesin e vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë drejtim, ndërmarrja e një rivlerësimi të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve është brengosëse", ka shkruar Shasha.

Osmani kundërshton konstatimet e KE-së për vetingun

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit Evropian se rivlerësimi i plotë dhe i njëhershëm i të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve paraqet shqetësim serioz. Në një konferencë për media, Osmani ka deklaruar se mungesa e vetingut do të ishte shqetësim serioz, e jo realizimi i këtij procesi. "Mosrealizimi i vetingut nuk u kontribuon as përpjekjeve të institucioneve të Kosovës për garantimin e sundimit të ligjit dhe as së ardhmes evropiane të vendit tonë", ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se procesi rivlerësimi të figurës së prokurorëve dhe gjyqtarëve do të vazhdojë. "Për dallim nga ajo që konstatohet në raportin e BE-së, ky proces do të jetë i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës. Për vite me radhë, raporte të ndryshme

vendore dhe ndërkombëtare kanë konstatuar ngecjet në sistemin e drejtësisë dhe mungesën e mekanizmave adekuatë për trajtimin e këtyre ngecjeve. Me mekanizmat ekzistues nuk do të ketë mundësi të realizohen reformat e dëshiruara në sistemin e drejtësisë", ka deklaruar Osmani.

Në raportin e progresit të KE-së për Kosovën, që u publikua më 19 tetor, është thënë se plani i Qeverisë së Kosovës që të bëjë veting të njëhershëm të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve është burim serioz i shqetësimit. "Një proces i tillë do të duhej të konsiderohej vetëm si një masë e jashtëzakonshme pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet dhe mekanizmat ekzistues për ta siguruar integritetin dhe për ta luftuar korrupsionin e titullarëve të detyrave gjyqësore. [Procesi] do të duhej të ishte në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe me këshillat e Komisionit të Venecias", është thënë në raportin e progresit.

Qeveria e Kosovës ende nuk ka vendosur për formën se si do ta bëjë vetingun. Më 13 tetor ajo ka miratuar koncept-dokumentin për vetingun në drejtësi i cili është thënë se ka për synim forcimin e sundimit të ligjit.

Në 24 orët e fundit janë dhënë mbi 5 000 doza të vaksinës kundër Covidit


PRISHTINË, 21 TETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 5 560 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 519 933 doza të vaksinës. Deri më sot 686 238 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i

Shëndetësisë Publike i Kosovës, nga 2 198 testime, 18 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të enjten janë shënuar edhe 23 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 157 106. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 510.



Anulohen zgjedhjet në Han të Elezit



PRISHTINË, 21 TETOR - Kandidatët për kryetarë të komunës së Hanit të Elezit do të dalin sërish në votime. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) në Kosovë të enjten ka marrë vendim për ta anuluar procesin zgjedhor për kryetar të kësaj

komune.

Në këtë vendim urdhërohet organizimi i sërishëm i votimit vetëm për kryetar të komunës. Zgjedhjet lokale në Kosovë u mbajtën të dielën, më 17 tetor. Në vendimin e PZAP-së thuhet se është pranuar e bazuar ankesa që

Rufki Suma, kandidati i pavarur dhe kryetar aktual i Hanit të Elezit, e ka bërë lidhur me këtë proces zgjedhor.

Sipas vendimit, PZAP ka konstatuar se është vërejtur qartë se ka pasur presion ndaj votuesve. "Po ashtu, ka pasur

organizim për të votuar dhe blerje të votës për ta votuar subjektin politik - Partia Demokratike e Kosovës", thuhet në vendim.

Kandidati i PDK-së për Hanin e Elezit, Mehmet Ballazi, ka arritur ta mposhtë kryetarin e

deritanishëm të kësaj komune, kandidatin e pavarur Rufki Suma. Rufki Suma ka mbajtur pozitën e kryetarit të Hanit të Elezit për 14 vjet.

Ndaj vendimit të PZAP-së palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën Supreme.

Rezultatet e zgjedhjeve lokale apo furtunë para qetësisë!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Rezultatet preliminare për asamblistë dhe kryetarë komunash të zgjedhjeve lokale:

Para zgjedhjeve lokale të datës 17 tetor 2021 dola me rezultat preliminar në gazetën "Epoka e re" së cilës i kam ndenjtur besnik që nga shkrimi i parë dhe që asnjëherë nuk kam pranuar të kompensohem nga ata për këto shkrime që janë të shumta dhe, po t'i përmbledhja për botime, do t'i bëja konkurrencë shokut Enver për numrin e veprave të botuara. Shkrimi apo analiza paraprake ishte për rezultat në nivel vendi (asamblistë) dhe për kryetarë të komunave.

Për rezultatit e përgjithshëm të LDK-së, PDK-së, AAK-së dhe LS-së ia kam qëlluar 100 për qind, kurse për LV-në kam dështuar rëndë sepse kam parashikuar që do të ketë 42 për qind të asamblistëve në nivel vendi kurse, sipas rezultateve, ende të pacertifikuara, ka afërsisht 26 për qind të pushtetit lokal në nivel vendi. Kurrë nuk e kam besuar se LV-ja do të ketë rezultat të tillë dhe as sot disi nuk po besoj, po më duket si një ëndërr apo makth. Kur kam parashikuar këtë rezultat jam mbështetur në 51 për qind të votave në nivel qendror dhe kohë e shkurtër, vetëm tetë muaj nga organizimi i zgjedhjeve të fundit ku LV-ja fitoi 51 për qind të votave. Pastaj, thuaja në asnjë vend në botë partia që ka pushtetin qendror nuk i humbet zgjedhjet lokale duke pësuar përgjysmim të votave. Duket se ende kam nevojë të mësojë! Ndërkaq, në garë për kryetarë të komunave ishte më lehtë të parashiheshin rezultatet për faktin se për partitë kryesore është edhe një

mundësi, balotazhi e që nuk është mundësi edhe për asamblistë komunash. Të shkojmë me radhë, sipas fuqisë politike të zgjedhjeve të fundit lokale për asamblistë komunale.

1. LV-ja: Nuk e fitoi asnjë komunë pa balotazh ndonëse kishte pushtetin lokal në tri komuna, Prizren, Mitrovicë dhe Podujevë, ndërkaq që në emër të LV-së ishin fituar edhe Prishtina dhe Kamenica. Pritjet kanë qenë që LV-ja të fitojë, pa balotazh Prishtinën, Podujevën dhe Prizrenin, si komuna të mëdha dhe disa komuna të vogla. Ambicijet (për shkak të kandidatit të mrekullueshëm) ishin të fitohej edhe Gjilani, por se nuk doli ky parashikim. Tash koalicionet para balotazhit dhe pazaret për poste dhe ndikim do ta përcaktojnë numrin e komunave që eventualisht do të fitohen nga LV-ja e që mundësitë janë te 12 komuna ku LV-ja është në balotazh. Do të jetë shumë sfiduese për faktin se mund të bëhen koalicione të mëdha kundër LV-së e që do t'ia vështirësonin rikthimin në balotazh. Është interesant fakti se, gjykuar sipas rezultateve të raundit të parë dhe mundësive për koalicione tash, LV-ja mund të fitojë shumë komuna, por mund të ndahet aspak mirë edhe pas balotazhit. Nëse LV-ja fiton zgjedhjet për kryetarë në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan, si dhe në ndonjë qendër më të vogël siç është Shtimja, atëherë mund të llogaritet si fituese. Prishtina është pika kryesore dhe synim i madh, dhe kushdo që e fiton Prishtinën lirisht llogaritet se e ka pushtetin lokal aq më parë që niveli qendror i

qeverisjes është në pronësi të LV-së ku ajo është aksionare kryesore me 51 për qind të aksioneve. Mirëpo, do të jetë tmerrësisht vështirë!

2. PDK-ja: Pas raundit të parë konsiderohet si fituese dhe është fituese për faktin se fitoi katër komuna, Mitrovicë, Ferizajn, Skenderaj dhe Hanin e Elezit, ndërkaq është me gjasa të mëdha të fitojë edhe 3-4 komuna të tjera pas balotazhit. Rezultati i PDK-së është befasi e madhe aq më parë që riktheu Mitrovicën, qendër të fortë të Agim Bahtirit që ishte kandidat i LV-së e që ishte gabim strategjik i LV-së. Kur kishte dyshime nëse ai do të ishte kandidat i LV-së, Agim Bahtiri kërcënoi haptas LV-në se: "Nëse nuk e përkrahin kandidaturën time atëherë do të investoj 1 milion euro në fushatën e Bedri Hamzës...". Kjo ishte mundësia e artë e LV-së të lirohej nga ky shantazhues duke e rinfirmuar premtimin kryesor elektoral me të cilat dominoi në zgjedhjet e përgjithshme, se do ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Po ta zbatonte këtë parim në rastin e Agim Bahtirit, cilido kandidat i LV-së për kryetar të Mitrovicës do t'i fitonte zgjedhjet, pa shkuar fare në balotazh. PDK-ja rikonfirmoi fitoren në Ferizaj në saj të një pune të mrekullueshme që e bëri kryetari Agim Aliu në punën e të cilit më së paku vërehej përcaktimi partiak e më së shumti dominonte interesi qytetar. Në Han të Elezit kam besuar se do të fitojë Rufki Suma, fitorja e Ballazhit për mua është befasi. Para zgjedhjeve edhe nuk kam qenë aq i sigurt se PDK-ja do të fitojë katër komuna e më së

paku se do ta fitojë Mitrovicën. Përtej parashikimeve të mia, PDK-ja mund të fitojë 7-8 komuna dhe nëse e fiton Prizrenin, PDK-ja do të bëjë gjumë të rehatshëm. PDK-ja arriti fitore të madhe dhe plotësisht të merituar në Skenderaj. Do të llogaritet si fituese e zgjedhjeve për faktin se nuk ishte favorite para zgjedhjeve. Për balotazh PDK-ja e ka një përparësi të madhe sepse të gjitha partitë mund të përfitojnë nga koalicioni me PDK-në e më së shumti LDK-ja.

3. LDK-ja: Dikush po thotë se është rikthim i madh i LDK-së e unë nuk e quaj ashtu; nëse kemi parasysh rezultatit e raundit të parë. Madje, në një mënyrë, nëse kemi parasysh fuqinë e pushtetit lokal para zgjedhjeve, LDK-ja ka prapaktim për faktin se fitoi pa balotazh vetëm dy komuna ndërsa i dërgoi në balotazh 4-5 komuna që më parë i kishte fituar pa balotazh, Fushë-Kosova, Gjilani, Vitia, Vushtrria dhe Istogu. Pejën e fitoi Gazmend Muhaxheri sikur që edhe Lipjanin e ka fituar Imri Ahmeti. Me punën që e ka bërë Imri Ahmeti në Lipjan, edhe po të dilte si kandidat i pavarur, do ta meritonte 100 për qind të fitonte edhe një mandat. Se si do të kalojë LDK-ja në balotazh e synimet i ka ta fitojë Prishtinën, Gjilanin, Podujevën, Istogun, Vitinë dhe Fushë-Kosovën, më shumë varet nga koalicioni me PDK-në, në radhë të parë edhe partitë e tjera se nga votuesi i LDK-së. Vetëm pas balotazhit do të konstatojmë nëse "fryma e re" e riktheu LDK-në apo do të kemi një vendnumrim. Zgjedhjet nacionale nuk mund të

krahasohen me zgjedhjet lokale, prandaj edhe krahasimet për rënie apo ngritje janë të pavenda!

4. AAK-ja: E ruajti konstantën e deritashme. Fitoi pa balotazh dy komuna, ndërsa ka mundësi reale të fitojë edhe 3-4 të tjera. Nëse e fiton kryeqytetin e AAK-së, Gjakovën, AAK-ja do të ndihej e qetësuar, dhe ka mundësi reale ta fitojë Gjakovën. Kam menduar dhe besuar se AAK-ja do ta fitojë pa balotazh Rahovecin në saje të punës shumë të mirë që ka bërë Smajl Latifi. Bali Muharremaj fitoi, plotësisht me meritë në Suharekë, sepse ka bërë punë të shkëlqyer.

5. LS-ja: Partia e Serbisë në Kosovë e jo e serbëve të Kosovës, Lista Serbe, do t'i fitojë 100 për qind të komunave. Tash ka fituar 9 komuna pa balotazh, i ka mbetur edhe 1 që e fiton pa asnjë problem. Agim Bahtiri e ka shantazhuar LV-në me një kandidaturë, LS-ja po e shantazhon Qeverinë dhe shtetin e Kosovës me një Zajbenicë që e ka projektuar si shtet të fuqishëm brenda një shteti të dobësuar. LS-ja ka kapacitet të madh shantazhues dhe destabilizues. E papranueshme për një shtet normal dhe një bashkësi ndërkombëtare normale!

Zgjedhjet lokale në Maqedoni të Veriut dhe në Kosovë, pasojat për nivelin qendror: Pak para zgjedhjeve lokale në Kosovë isha në Kërçovë dhe Strugë. Në të njëjtën kohë mbaheshin zgjedhjet lokale edhe në Maqedoni të Veriut ku për zgjedhje lokale garonin dy koalicione; LSDM-ja dhe BDI-ja, në njërin anë dhe VMRO -

Krijimi i Gjykatës Komerciale, ndihmesë e madhe për operimin e bizneseve të vogla

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 TETOR - Ndikimi dhe përfitimet nga themelimi i Gjykatës Komerciale për sektorin privat në Kosovë, si dhe përmirësimi i klimës së investimeve, ishin disa nga temat të cilat u diskutuan gjatë një forumi të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi i USAID-it për Drejtësi Komerciale, me hisedarë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe

sektori privat.

Doarsa Kica-Xhelili, deputete dhe kryesuese e grupit punues pranë Komisionit Parlamentar Legjislativ, ka theksuar rëndësinë e formimit të Gjykatës Komerciale dhe ka përmendur lehtësimin e operimit të bizneseve pas formimit të tij. Ajo ka thënë se si kryesuese e këtij grupi punues konsideron se miratimi i Ligjit për Gjykatën Komerciale është esencial për nivelin e vendit dhe për t'i lehtësuar proceset dhe zgjidhjet e shpejta të konteksteve, duke theksuar në veçanti trajtimin e barabartë që kjo gjykatë ua ofron të gjitha

bizneseve.

Kica-Xhelili u shpreh se janë të gatshëm që ta shtojnë votimin për themelimin e kësaj gjykate në një afat sa më të shpejtë, gjithmonë duke konsideruar edhe sugjerimet dhe komentet e institucioneve dhe organizatave përkatëse për themelimin dhe mbarëvajtjen e saj.

Këshilltarja ligjore e kryeministrit të Kosovës, Tea Blakaj-Hoxha, ka përmendur risitë në rast të themelimit të një gjykate të tillë. Sipas saj, Gjykata Komerciale do të jetë shembull edhe për gjykatat e tjera për mënyrën e menaxhimit dhe funksionimit të saj. Përveç

kësaj, ajo shtoi se objekti i ri, pas themelimit të kësaj gjykate, do të ketë rritje të numrit të gjyqtarëve të rinj dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.

"Gjykata Komerciale rrit transparencën dhe llogaridhënien", ka deklaruar ajo.

Chris Thompson, udhëheqës i programit të USAID-it për drejtësi komerciale, përmendi rëndësinë e Gjykatës Komerciale për rritjen e vendeve të punës dhe krijimin e hapësirës adekuate për investimet e huaja, edhe ato vendore në Kosovë.

Thompson ka thënë se menaxhimi i vështirësive të

gjykatës i vëzhguar nga komuniteti i biznesit, sistemimi i gjyqtarëve, shqyrtimi i rasteve në mes bizneseve dhe qeverisë, si dhe adresimi i konteksteve në një adresë të vetme dhe të duhur, janë disa nga lehtësimet që do t'i sillte themelimi i Gjykatës Komerciale.

Avokati nga "Shita&Ibrahimaga", Ardi Shita, njëherësh edhe moderator i kësaj tryeze, tha se nuk ka zgjidhje më të mirë për përmirësimin e të bërit biznes se themelimi i Gjykatës Komerciale dhe kjo nuk vlen vetëm për shtetin e Kosovës, por edhe për vendet e tjera të rajonit.



Aleanca, në anën tjetër. Me Tahir Zhidovin, vëllaun e të ndjerit Orhan Hani me të cilin isha në shkollë të mesme në Prishtinë, u takuam në Llogorin e Stara Gradishkës në Kroaci, si të dënuar politikë e që pastaj këtë miqësi e vazhduam deri më sot. Tahiri ka një ndjeshmëri të stërholluar politike ku çdo gjë sillet dhe pëshillet te interesi kombëtar ku Tahiri nuk bënë lëshime me asnjë kusht. Kjo mbase ka qenë përcaktuese që nuk i ka arritur majat e pushtetit sepse, as nuk ka qenë e as nuk bëhet konformist apo përshtatës për arritje të qëllime që i shërbejnë për të fituar apo gllabëruar poste politike. Biseduam për gjasat që i kanë subjektet politike shqiptare në zgjedhje lokale dhe ai, si anëtar joortodoks i BDI-së tha se BDI-ja ka përparësi para partive tjera shqiptare dhe se do të fitojë komunat shqiptare. Shpresonte se edhe LSDM-ja, si partner koalicioni në nivel qendror por edhe lokal do ta përkrahë BDI-në. Vërejtja ime ishte, jo të BDI-në por te LSDM-ja sepse isha i sigurt se në këto zgjedhje VMRO-ja do të ketë rritje të ndjeshme e që nënkupton pakësimin e përkrahjes së BDI-ja nga një

partner i dobësuar siç është LSDM-ja. Ashtu edhe doli. Tash është e qartë se VMRO-ja ka fituar 60,000 vota më shumë se LSDM-ja dhe duket se LSDM-ja e ka humbur legjitimitetin qeverisës. Hipotetikisht e që lehtë mund të jetësohet nëse BESA i tërheq katër deputetë nga Sobranja (Kuvendi) i Maqedonisë së Veriut, koalicioni qeverisës LSDM - BDI mbetet me 58 deputetë nga 120 deputetë sa i ka ky Kuvend e që nënkupton automatikisht ndërrimin e koalicionit qeverisës. Kjo ishte sa i përket Maqedonisë së Veriut. Po si mund të zhvillohen ngjarjet në Kosovë, do të merret vesh pas balotazhit, muajin që vjen.

Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë, 59 i ka LV-ja dhe 20 pakicat e që janë 79 e që konsiderohet si një koalicion i qëndrueshëm dhe stabil. Opozita nuk ka mundësi, as të provokojë rrëzimin e qeverisë e as zgjedhje të reja kurse proceset politike lehtësisht mund ta përmbysin situatën. Nëse LV-ja këmbëngul se nuk do ta formojë Zajebnicen në këtë formë dhe në këtë përmbajtje kurse Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare po insiston që Zajebnica të formohet pikërisht mbi këto baza, atëherë

do të ketë zhvillime tjera. LS-ja ka paralajmëruar largimin nga të gjitha institucionet e Kosovës, nga Kuvendi dhe Qeveria e që nënkupton 10 deputetë më pak. Nëse tensionohet situata shkak se palët do të barikadohen në qëndrimet që i kanë, bashkësia ndërkombëtare do të ndikojë që edhe deputetët e pakicave joserbe të largohen nga Kuvendi duke provokuar edhe rrëzimin e qeverisë përmes mocionit. Jam i sigurt se nëse ambasadori i ri i SHBA-ve në Kosovë do ta luaj rolin që i kërkohet; një shëtitje nëpër hapësirat e paeksploruara të Ambasadës amerikane në Prishtinë, bashkë me presidenten do të ndikojë që edhe deputetët e Vjosa Osmanit do të largohen nga kuvendi dhe koalicioni qeverisës. Nëse amerikanët vlerësojnë se duhet të kërkohet diçka më tepër, një vizitë e presidentes në SHBA dhe një takim me presidentin Bajden, si baba të Asociacionit, jo që do ta bind presidenten që ta pranojë Asociacionin por do ta shndërronte në kundërshtar të Albin Kurtit. Prandaj, nëse bashkësia ndërkombëtare vlerëson se duhet të luftohet Albin Kurti, në mungesë të një kundërshtari kredibil dhe serioz,

Vjosa Osmani është alternativa thuaja e vetme dhe e besueshme. Dhe, jam i sigurt se Vjosa Osmani do ta bënte këtë me kënaqësi të madhe. Do të harrohej sjellja e Vjosa Osmanit ndaj Hashim Thaçit kur do ta shihni se si do të sillej ndaj Albin Kurtit. Dhe këtë do ta bënte me pasionin më të madh. Nuk kam asnjë dyshim për këtë. Mirëpo, jam i sigurt se Albin Kurti i nuhatë shumë mirë dhe me kohë zhvillimet e proceseve e sidomos kur kanë të bëjnë me lëkurën e tij prandaj nuk do të lejojë që, të gozhdur ta bartin, sikur Krishtin nëpër Autostradën e Dhimbjeve - Via Dolorosa për ta vendosur në kryqin me kurorë prej therrave të murrizit.

Albin Kurti do të tërhiqet duke provokuar zgjedhje të tjera. Albin Kurti ka plotësisht të drejtë për Zajebnicën, por nuk ka fuqi ta kundërshtojë dhe të vazhdojë të mbetet në pushtet. Nuk e lënë këta që po e duan Zajebnicen. Me një fjalë, fati politik i Albin Kurtit nuk varet nga rezultati i balotazhit, por nga qëndrimi dhe vendimi i faktorit vendimmarrës ndërkombëtar se me cilin ekip duan ta përfundojnë lojën e arritjes së një marrëveshjeje me Serbinë. Ndërkombëtarët nuk pyesin për çmimin që duhet ta

paguajë Kosova dhe duhet të kuptohet se ekipi amerikan diplomatik në Ballkan, në krye ambasadorin Hill, nuk ka ardhur këtu për t'i dëgjuar dëshirat e Albin Kurtit, Vjosa Osmanit apo Behxhet Shalës, por kanë ardhur për të kryer punë e që është nënshkrimi i një marrëveshjeje me Serbinë, pasi që ta kenë themeluar Zajebnicën, baba i së cilës është Joe Bajden, president aktual i SHBA-së. Dikush mund të më fajësojë për mungesë të vizionit, optimizmit dhe heqjes dorë nga qëndrimet e mia të forta kundër Zajebnicës. Ka diçka të vërtetë këtu, por e kam kuptuar se e drejta, edhe nëse është në anën tuaj, e është, pa asnjë dyshim, në mungesë të forcës kalon tek ai që e ka forcën! Albin Kurti në rastin konkret është në pozitë, ose-ose, e pranon propozimin ndërkombëtar apo nuk e pranon, mundësi tjetër nuk ka. Për fat të keq, Albin Kurti është në pozitë vetëm ta menaxhojë procesin e përpjekjeve për pakësimin e humbjeve dhe dëmeve që i kanë shkaktuar të tjerët, asgjë më tepër! Çdo përpjekje vetëm sa do ta dobësojë pozicionin e Kosovës dhe humbjet do të jenë më të mëdha. Qofsha i gabuar në këtë fall që po bëj!

Banka Botërore: Kosova duhet të përqendrohet në krijimin e vendeve të punës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 TETOR - Kosova dhe pjesa tjetër e rajonit të Ballkanit Perëndimor po rikthehen nga recesioni i vitit 2020 i shkaktuar nga Covid-19 falë një rimëkëmbjeje më të shpejtë sesa pritej. Kështu thuhet në edicionin e fundit të raportit të rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, Rimëkëmbje e Gjellbër, që u publikua të enjten. Prodhimi në vitin 2021 në Kosovë pritet të tejkalojë nivelet e vitit 2019 deri në fund të vitit, por rreziqet për parashikimin mbeten të larta pasi vendi vazhdon të përballet me pandeminë.

Aktiviteti ekonomik në vitin 2021 pritet të zgjerohet me 7.1 për qind pas një rikthimi më të fortë sesa pritej në vizitat e diasporës, rikthimin e besimit të konsumatorëve dhe rritjen e kredive për konsum.

Eksportet e mallrave vazhduan zgjerimin dhe diversifikimin gradual të tyre nga viti 2020. Megjithatë, presionet e ndjeshme të inflacionit, kryesisht nga çmimet më të larta të importit, mund të minojnë një rimëkëmbjeje më të fortë në investimet private. Të hyrat publike po përjetojnë një rikthim të paparë për shkak të aktivitetit më të lartë ekonomik, por edhe për shkak të inflacionit



më të lartë dhe masave të përmbytshme tatimore. Si rezultat, dhe kundrejt nënëkzekutimit në investimet publike, deficitit fiskal pritet të ulet në 2021.

Menaxhimi i pandemisë, duke përfshirë vaksinimin e përshpejtuar, mbetet prioritet në të ardhmen e afërt. Valët dhe variantet e reja të pandemisë mund të rëndojnë perspektivën e rritjes nëse rivendosen kufizime më të repta ndërkombëtare apo brenda vendit në lëvizje. "Duhet të krijohet një shtytje për më shumë mundësi ekonomike, me

politika dhe investime që fokusohen në reforma afatgjata për të transformuar rrënjësisht modelin e rritjes së Kosovës në një model që krijon vende të punës duke u udhëhequr nga produktiviteti më i lartë", ka thënë Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Ai ka theksuar se e njëjta thirrje vlen për të gjithë rajonin. Sipas këtij raporti, perspektiva për rajonin është përmirësuar ndjeshëm, me rritje të PBB-së që

tani parashikohet të arrijë në 5.9 për qind në 2021, pas tkurrjes prej 3.1-përqindësh në vitin 2020.

Në raport theksohet rritja në rajon parashikohet të arrijë 4.1 për qind më 2022 dhe 3.8 për qind më 2023. "Norma e varfërisë për rajonin parashikohet t'i rikthehet trendit të saj parapandemik me rënie dhe të bjerë me rreth 1 pikë përqindjeje në 20.3 për qind, afër nivelit të vitit 2019. Rimëkëmbja në të gjithë rajonin vjen për shkak të fuqisë si në kërkesën e brendshme, po ashtu edhe në atë të jashtme. Një rikthim i mprehtë

i konsumit të brendshëm dhe udhëtimeve në të gjithë Evropën ndihmoi në rritjen e remitancave të emigrantëve si dhe flukseve hyrëse të turizmit gjatë sezonit të verës të vitit 2021. Një rimëkëmbje e fortë në ekonominë e përparuar i dha gjithashtu hov kërkesës për eksportet e rajonit", theksohet në raport, duke shtuar tutje se rimëkëmbja mbetet e brishtë.

Në raport theksohet se humbjet e vendeve të punës nga recesioni dhe pasojat e tij kanë prekur në mënyrë joproporcionale gratë dhe të rinjtë, gjë që mund t'i pengojë përpjekjet për t'i rritur normat historikisht të ulëta të rajonit sa i përket pjesëmarrjes së tyre në fuqinë punëtore.

Sipas këtij raporti, papunësia e të rinjve u rrit në 37.7 për qind më 2021 në Ballkanin Perëndimor, me 5.4 pikë përqindjeje nga qershori 2020, duke përkeqësuar më tej perspektivat e punësimit të të rinjve. "Ndërsa vendet e Ballkanit Perëndimor përgatiten për të ardhmen pas pandemisë, qasja ndaj politikave duhet të përqendrohet në adresimin e pengesave kryesore për krijimin e vendeve të punës dhe transformimin ekonomik, duke përfshirë tranzicionin e gjellbër", ka deklaruar Linda Van Gelder, drejtoreshë e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor.

Kosova së bashku me USAID-in synon ta fuqizojë sektorin e energjisë së ripërtëritshme

Prishtinë, 21 tetor - Më 27 shtator 2021 aktiviteti për energji të qëndrueshme i USAID-it dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit për ta promovuar zhvillimin e sektorit të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë.

Përmirësimi i zbatimit të projekteve të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë me ndihmën e zonimit gjeo-hapësinor i ka bashkuar këto dy institucione me sinergji unike për t'i fuqizuar më tej burimet e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Një prej sfidave kryesore që kanë identifikuar zhvilluesit e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë është mungesa e të dhënave sa iu përket lokacioneve specifike që mund të shfrytëzohen për të zhvilluar projekte të erës dhe solare.

Në gjashtë muajt e ardhshëm MMPHI-ja përmes mbështetjes së Aktivitetit për energji të qëndrueshme të USAID-it do të angazhojë të paktën pesë studentë dhe të posadiploimuar nga grupi i parë i programit të punës praktike 'Energjia e Re' për të lansuar aktivitetet e hartës



zonale të MMPHI-së si pjesë e këtij memorandumi.

Ky program, po ashtu, do t'i mbështesë përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për të identifikuar mundësi të reja pune për të rinjtë e kualifikuar dhe integrimin e tyre në sektorin premtues të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Programi i punës

praktike do t'ua mundësojë studentëve dhe të diplomuarve, në veçanti të rinjve, minoriteteve, grave dhe personave të marginalizuar për ta promovuar energjinë e ripërtëritshme dhe për ta identifikuar gjeneratën e ardhshme të ekspertëve të energjisë në vend.

USAID-i, përmes aktivitetit për energji të qëndrueshme, synon që ta ndihmojë MMPHI-në gjatë gjithë procesit të përgatitjes së hartave zonale dhe përditësimit e gjeoportalit të Kosovës, me theks në identifikimin dhe kategorizimin e të gjitha tokave publike dhe vendosjen në hartë të zonave që potencialisht mund

të shfrytëzohen për zhvillimin e projekteve me kapacitet të madh të energjisë së ripërtëritshme. Për më tepër, kjo asistencë do t'i mbështesë përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për ta transformuar sektorin e energjisë në Kosovë duke nxitur zhvillimin e opsioneve për energji të ripërtëritshme.

Michael Caine për jetën, politikën dhe largimin nga filmi

Karriera e tij shpërtheu në vitet '60 të shekullit të kaluar, si pjesë e një brezi të ri aktorësh. 60 vjet më vonë, në heshtje po ia jep lamtumirën e fundit filmi. Bashkëbisedimin e gazetarit Xan Brooks për ditoren "the Guardian", me legjendën e aktrimit Michael Caine, Telegrafi e sjellë si më poshtë.

Michael Caine është 88 vjeç. Ecën me bastun. Ka një këmbë të çalë dhe probleme me boshtin kurrizor. Tregon se rastet e vetme kur këto ditë e lë shtëpinë janë ato kur gruaja e tij ka kohë që ta nxjerr jashtë me makinë. Javën e kaluar ia dërguan një skenar për një karakter që ikën nga një bandë hajdutësh, dhe kjo e bëri të qeshtë – ideja se ai mund ta luajë atë. "Nuk mund të eci e lëre më të vrapoj", thotë ai. "Dhe, në një mënyrë kam mbaruar me filmat". Pothuaj ishte i mbaruar, meqë nuk ka marrë pjesë në asnjë film për më shumë se një vit. U fut në filmin e tij të fundit, "Best Sellers", para se të godiste pandemia e koronavirusit. Sot dyshon se do ta bëjë një tjetër film; gjë normale për të e jo një humbje e madhe. I ka titullin e kalorësit dhe Oscarët. Çfarë i ka mbetur tjetër ta dëshmojë veten? Për këtë thotë: "I kam 150 filma. Mendoj se mjaft kam bërë".

Për një kohë të gjatë Caine ka qenë si orendi që përshtatej lehtë – si pjesë e mobileve, një fytyrë e njohur në ekran – ndaj të shqetëson paramendimi i peizazhit pa të; si të hysh në Kullën e Londrës e të shohësh se korbat kanë ikur. Është akoma më shqetësuese fakti të kuptosh se kjo tashmë mund të ketë ndodhur; se ka dalë në pension pa bërë zhurmë. Caine e kaloi pjesën e parë të karrierës duke mësyre barrierat dhe në të dytën duke e shijuar plaçkën e suksesit. Dikush do ta priste një akt të madh final, një rol të fundit mahnitës. Në vend të kësaj, e kemi këtë: një largim të thjeshtë.

Aktori flet përme video-lidhjes nga shtëpia e tij në Sërej (hera e parë, siç thotë ai, që jep intervistë në këtë mënyrë). Ai do të duhej ta promovonte filmin e tij "Best Sellers", rolin e mirë të autorit të vjetër dispeptik që bëhet sanzacion viral. Por, nuk e ndjen këtë; duket se ka vazhduar me planet e veta. Kur i them se kam dëgjuar se e bazoi personazhin e Harris Shawit tek një regjisor i vjetër monstruoz me të cilin dikur punonte, reagon me një injorancë totale duke thënë se nuk mund ta di se për këtë e kam fjalën. "Nuk e mbaj mend. Mund ta kem bërë. Kanë kaluar dy vjet qëkur e bëra, kështu që është qesharake të flasësh tash për të". E pa çajin e tij. "Pastaj, jam 88 vjeç. Mendja ime nuk e kthjellë si dikur."

"Shih ti", shton ai, "kjo është një tjetër gjë që duhet marrë parasysh. Dua të them se jam

mirë, mirë. Por, nuk mund të ec dhe nuk mund të qëndroj shumë gjatë në këmbë, e tash nuk e di nëse kujtesa ime e shkalfitur po ikën krejt. Kam punuar me njerëz të tillë. Kam punuar me një aktor i cili i kishte të gjitha fjalët e tij të shkruara në mur, sepse nuk i mbante mend. Dhe, ka të tjerë që mbajnë kufje e që e kërkojnë suflerin ta lexojë rreshtin tjetër për të. Johnny Depp. Ai e bën këtë [Depp e thotë të kundërtën]. Nuk mbaj mend kush është tjetri. Aktor më i vjetër amerikan. Ishte shumë kohë më parë".

Kur ndodhi mbyllja e pandemisë, Caine u përball me një zgjedhje. Ose të rrinte në shtëpi e ta shikonte televizorin gjatë gjithë ditës, ose ta shtonte një qark të ri në zinxhirin e sukseseve. Kështu që u ul dhe e shkroi një roman, një thriller – sfida e tij e parë në letërsi pas disa memoareve. Këtë vepër do ta botojë vitin e ardhshëm, meqë po e rishkruan dhe po rregullon, për ta bërë më të mirë. "Paragrafët", thotë ai, duke qeshur. "Pikësimi, gjithçka."

Cili është titulli dhe për çfarë bëhet fjalë?

"Epo", thotë ai. "Titulli është 'Nëse nuk do të vdesësh'. Kam lexuar vetëm thrillerë. Jam tip aventurier, jo tip i letërsisë, kështu që nuk po synoj ta zëvendësoj Shekspirin. Por, bazohet në diçka që kam lexuar dikur për dy pastrues, për dy mbledhës plehrash në Ist End". Një pauzë dramatike. "Dhe, ata gjejnë uranium në mbeturina".

Si djalë i ri në jug të Londrës, pasionet e tij ishin filmat dhe librat, kinemaja dhe biblioteka. E përmbylli pjesën e kinemasë, kështu që mendon se duhet t'i kthehet bibliotekës – në mënyrë metaforike meqë ndërtesa ku shkonte dikur është zhdukur prej kohësh. Herën e fundit që vizitoi 'Elefantin dhe Kështjellën' vërejti se ishte zëvendësuar me një bllok banesor. Por, ky është përparim, tjetra është histori. Përfshin ndryshime të mira dhe të këqija. Kur e nisi punën si aktor, për shembull, filmi dhe teatri britanik ishin ruajtës të madhësisë. "Ishte si: 'Filani po e bën një gosti dhe të gjithë janë veshur me kostume'. Një tjetër e qeshur e shkurtër. 'Pastaj u futëm ne dhe i ndryshuam të gjithat'."

E shikojmë karrierën e hershme të tij në terma gjithëpërfshirës historikë. Ishte tip i zakonshëm, ngucakeq, hero i klasës punëtore me theksin e pastër të Temzës, djalosh me syze i lindur për posterë të ndryshimeve shoqërore të viteve 1960. Tani ka arritur në pikën kur ka filluar ta shikojë veten në ato aspekte, si pjesë e një brezi të ri aktorësh që përfshinin emrat si Albert Finney, Richard Harris, Peter O'Toole dhe Tom Courtenay. Por, në ato kohë, natyrisht, ai e çonte jetën si në një fotografi pa perspektivë. "Rrija në diskutokë", thotë ai. "Nuk dija



çfarë dreqin po ndodhte".

Ndonjëherë, duke kaluar nëpër kanale televizive, do ta kapë ndonjë pjesë të klasikëve të tij. Mund të jetë duke e luajtur Harry Palmerin e qetë në "The Ipcress File", Jackun e vështirë në "Get Carter", ose Peachy Carnehan e lodhur te "The Man Who Would Be King". Por, thotë se nuk ka interes të rishikojë lavditë e vjetra dhe se rrallë kthehet prapa në karrierën e tij. Mendon se "Alfie" ishte ndoshta filmi më i mirë që e bëri, por këtë e bazon në kujtesë pa i ka përditësuar skedarët. "E kam parë vetëm dy ose tre herë".

Ajo që i mungon, nëse ka diçka, janë njerëzit e jo filmat. Filmat janë atje në iPad-in e tij sa herë që ai dëshiron t'i shikojë. Por, shokët e tij kanë ikur; edhe ata i përmbyllen largimet e tyre. "Brez i im po shkon. Të gjithë miqtë e mi po vdesin. Sepse, të gjithë jemi plakur. Roger Moore dhe Sean Connery ishin dy nga miqtë e mi më të ngushtë që ikën. Nja dy ditë më parë iki Johnny Gold, që ishte pronar i diskutokës 'Tramp' në Londër. E kam një shok tjetër shumë të ngushtë që është shumë, shumë i sëmurë. Befasohem nëse mbijeton deri në fundjavën e ardhshme. Nuk do ta përmend emrin e tij, por do të lexoni për të në gazeta".

Pyes nëse mendon se shteti është në gjendje më të mirë sot, sesa kur e nisi karrierën, apo nëse progresi shoqëror që e mishëroi atëherë është i përmbysur. "Nuk e di", thotë ai. "Ende asgjë nuk është perfekte. Ndoshta kurrë nuk do të jetë. Shikoje gjendjen ku jemi tash. Nëse rritesh sot je në një kohë të vështirë".

Në të kaluarën, Caine e ka përshkruar veten në mënyra të ndryshme, si një tori i majtë dhe si socialist i krahut të djathtë. Tradicionalisht (por, jo ekskluzivisht) i voton konservatorët. E adhuron Margaret Thatcherin, e respektoi David Cameronin dhe votoi në referendumin e vitit 2016. Një ditë, mendoj unë, mbase do ta rishqyrtoj atë pozicion, por tash jo. Ai ende e mbështet Brexit-in, pavarësisht kaosit të zinxhirit aktual të furnizimit; pavarësisht krizës në rritje të karburanteve dimërore.

"Oh, kjo është të mësosh nga telashet", thotë ai. "Ashiqare nuk do të bëhet mirë menjëherë". Pastaj ndryshon pak qëndrimin. "Dua të them se nuk e di se çfarë do të ndodhë. Më duhet të pres që Boris të kthehet nga pushimet. Në fakt, ta bësh këtë, të shkosh në pushime tash, kjo është e pabesueshme. Raftet bosh. Njerëzit në radhë për benzinë. Dhe thua: 'Prit veç pak. Ai ka shkuar në Marbella'?"

Pra, veç pak – ai mendon se Brexit-i është i mirë, por nuk është i kënaqur me Johnsonin, personalisht? "E mbështeta. Mendova se ishte i mrekullueshëm. Por, tash jam shumë i zhgënjyer prej tij. Bëri gabim të madh atje, duke shkuar në Marbella. Të shohim nëse kur të kthehet do të mund t'i zgjidhë të gjithat. Përndryshe, mund të kemi një qeveri socialiste". Dhe, a mund të votojë për të? "Mbase. Kurrë nuk i dihet. E bëra më parë. E bëra me Blairin. E bëra me dikë tjetër; po harroj kë, se ishte shumë kohë më parë. Gjithmonë votoj sipas asaj që mendoj. Atë që është e mirë për ne. Atë që është e mirë për shtetin".

Ai, dyshoj unë, është një tori klasik i klasës punëtore – i rritur në varfëri, burrë i vetëbërë. Nëse je rritur i varfër, paratë kanë shumë rëndësi. Doni t'i grumbulloni. Doni t'i mbani. Ndoshta mendon se ka diçka që i mungon.

"Jo, jo, jo", kundërshton Caine. Ai nuk e mendon këtë. Është i mbushur me para, i larë nga paratë "Kam jetuar gjithmonë në kufirin më të lartë që e lejonin paratë e mia. Dua të them, nuk jam ekstravagant. Nuk jam budalla. Nuk blej havjar për çdo ditë. Por, po, unë flas me ju nga një shtëpi e madhe me 10 hektarë tokë. Është fantastike, sepse kjo do të thotë se nipërit e mbesat e mia mund të vijnë e të më vizitojnë, por zhidukun në çast dhe thjesht vrapojnë. Dy milje duke vrapuar rreth e qark kopshtit".

Edhe një herë e kontrollo veten. Bëhet emocional për shtëpinë e tij në fshat, por realiteti është se ajo shtëpi e kreu të veten. E bleu 30 vjet më parë si shtëpi të madhe familjare, mjaft e madhe për ta strehuar atë, gruan e tij të dytë

Shakira, dy vajzat dhe tre nipërit e tij. Këto ditë është kryesisht ai dhe Shakira duke u sjell vërdallë. "Pra, do ta marr një më të vogël", thotë ai. "Sepse, nipërit dhe mbesat kanë shkuar që të gjithë. Ata të gjithë po rriten. Kështu që do të shkoj për të qenë më pranë tyre, aty ku e kanë më të lehtë të më vizitojnë. Do të shkoj në Uimbëldon. Vajza ime, Natasha, jeton atje".

U quajt Maurice Micklewhite, sipas babait të tij që punonte si roje i tregut të peshkut. Kam lexuar se e ndryshoi emrin, zyrtarisht, disa vjet më parë, sepse u lodh me shpjegimet sa herë që rreshtohet në kontrollin e pasaportave në Mbretërinë e Bashkuar. Por, thotë se kjo nuk është e vërtetë: e ndryshoi atë shumë vjet më parë, të paktën 10 vjet. Më duket se kështu e ndërpreu lidhjen e fundit me të kaluarën e tij.

Kur u bë Michael Caine, natyrisht, njerëzit ende e quanin Maurice. "Por, tash nuk e kam asnjë anëtar të familjes, kështu që me vite të tëra askush nuk më quan më Maurice. Të gjithë kanë vdekur. Vëllai im, nëna ime, babai im. Nëse kam ndonjë lidhje tjetër, ata do të jetonin në Bermondsej". I ngre supet. "E, unë nuk shkoj në Bermondsej".

Po ai? A është Maurice, thellë në zemër? "Jo. Ditën që u bëra Michael Caine, unë isha Michael Caine. Jo më Maurice, po një person krejtësisht tjetër. Ishte gjë e mahnitshme. Përrallore".

Çfarë nuk shkante me personin Maurice? "Epo, askush nuk e njihje. Ishte pa para. Ishte i papunë. Në momentin që u bëra Michael Caine, kisha një punë dhe rrugëtimin tim".

Kthehet pastaj në një anekdotë që me siguri e ka thënë 100 herë më parë – në ahengje, në diskutokë, në biseda dhe para auditorit. Është rrëfimi sesi e bëri çarjen e madhe me filmin "Zulu" të vitit 1964; si u takua me regjisorin amerikan Cy Endfield, në barin e teatrit, për t'i thënë se pjesa që ai e donte kishte shkuar te një aktori tjetër. Pse mendoi se e kishte saktë? A u kthye në varfëri dhe në harresën e dikurshme? A ishte sërish Maurice Micklewhite?

Ai thotë: "E gjithë karriera ime e filmit bazohet në gjatësinë e banakut të teatrit 'Princi i Uellsit', sepse isha duke dalë dhe ecja ishte shumë e gjatë deri te dera. Sapo arrita atje, ai thirri: 'Kthehu!' Kishte vendosur që mund të luaj rolin e oficerit. Më tha: 'Dukesh oficer'. Kjo sepse isha 1.88 metra i gjatë e blond. Dera ishte gjysmë e hapur; unë pothuajse e kalova atë. U ktheva dhe hyra përsëri".

Jeta e tij më bën të mendoj për Dick Whittingtonin, duke u kthyer përsëri në rrugë drejt Londrës. "Pikërisht", thotë Caine. "Pikërisht ai jam: Dick Whittingtoni i aktrimit". /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Daci: Ndjenjë e veçantë të luaj në elitën e basketbollit në Turqi



PRISHTINË, 21 TETOR - Saranda Daci ka debutuar në elitën e basketbollit turk, për skuadrën Bursaspor, që pësoi humbje nga Antalya 76:75. Ky është një hap i madh në karrierën e basketbollistes nga Peja, por edhe për basketbollin femëror në Kosovë. "Kjo ka qenë ndeshja e parë për mua në Ligën e Turqisë, ku edhe njihet mjaft mirë në Evropë, si një ndër ligat më të forta evropiane. Ishte një ndjenjë e mirë dhe e veçantë për mua për shkak se ishte ndeshja debutuese dhe shumë dramatike saqë edhe humbëm në sekondat e fundit për vetëm një

pikë", ka thënë Daci për faqen zyrtare të FBK-së. "Ka qenë një paraqitje e mirë, pasi për 18 minuta sa isha në lojë kisha gjashtë pikë, pesë kërcime, katër asistime, një top të vjedhur dhe një bllokadë. Kam marrë besim se mund të jap edhe më shumë në ndeshjet e tjera, ku së bashku me vajzat e ekipit do të luftojmë për më të mirën deri në fund", ka shtuar tutje basketbollistja pejane.

Një nga basketbollistet kryesore të Përfaqësueses së Kosovës ka folur edhe për mikpritjen në Turqi. "Në Turqi po ndihem si në shtëpinë time

mbase për shkak që njerëzit janë të afërm sikur te ne, por edhe kultura mes vendit tonë dhe Turqisë është pothuajse e afërt. I falënderoj për mikpritjen si vajzat që janë të mrekullueshme me një atmosferë dhe harmoni të mirë, po ashtu njëjtë edhe stafi që është i palodhshëm", ka shtuar Daci, e cila më parë ka luajtur edhe në Superligën e Republikës së Çekisë, kurse në Kosovë ka fituar shumë trofe me Penzën, Prishtinën dhe Bashkimin. "Të luaj në një ligë, siç është kjo në Turqi, do ta cilësoja si një vlerë të madhe në karrierën time", ka përfunduar Daci.

SHKURT

Valmir Veliu, 'ylli i javës' në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare BKT Kosova, vazhdojnë të japin çmimin "Ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. "Ylli i javës" i xhiros së 10-të në BKT Superligë është shpallur futbollisti Valmir Veliu, anëtar i KF Llapi. 21-vjeçari është ndër lojtarët më të spikatur të skuadrës llapjane si me lojën e shfaqur, po ashtu edhe me golat e asistimet e tij. Veliu shënoi 2 gola dhe bëri një asistim në ndeshjen e javës së 10 që skuadra e tij e mposhti FC Ulpianën me rezultat të thellë 0-6. Me këtë fitore Llapi është këndellur dhe ka dalë nga zona e rrezikshmërisë në BKT Superligë. Çmimin "Ylli i javës" për sulmuesin e skuadrës së Llapit e dorëzoi Bashkim Kurti, menaxher i degës së BKT-së në Podujevë.

Halili paraqitet me shqiponjë te Porto

Futbollisti Diar Halili ka firmosur me ekipin e të rinjve të Portos. Mbrojtësi vijon traditën e yjeve të Besës së Pejës që kanë firmosur në Portugali. Gjigantët e Portos kanë të drejtë për ta blerë kartonin pas huazimit njëvjeçar, me Halilin që bëhet futbollisti i dytë që kalon nga Besa e Pejës te Porto pas Gentrit Salihut. Diar Halili në sezonin që lamë pas luajti 29 ndeshje si titullar me Besën e Pejës edhe pse në moshën 18-vjeçare, duke gjetur edhe golin. Ai është pjesë e moshave U-19 të Kosovës.

Ramosi debuton ndaj Lilles


Një nga transferimet më të bujshme të merkatos së verës ishte edhe kalimi i Sergio Ramosit nga Real Madridi te PSG. Një largim pas 16 vjetësh si madri nën nuk e pengoi atë të zgjidhte të vazhdonte karrierën në Paris. Por Sergio Ramosi ende nuk ka debutuar me parisienët. Mbrojtësi spanjoll vuan nga një dëmtim në këmbë që nga fundi i korrikut dhe vetëm tani po jep shenja të rikuperimit. Pas një pushimi tremujor, mjekët e PSG-së theksojnë se lojtari mund të kthehet në stërvitjen e parë me ekipin nga java e ardhshme. Ramosi pritet të debutojë me PSG-në më 29 tetor në ndeshjen ndaj Lilles.

Kosova bie në renditjen e FIFA-s, Shqipëria ngrehet

PRISHTINË, 21 TETOR - Kosova e ka shënuar një rënie të madhe në ranglistën botërore të ekipeve kombëtare të FIFA-s pas publikimit të renditjes më të re nga shtëpia e futbollit botëror të enjten. Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pësuar rënie në renditjen e FIFA-s pas ndeshjeve të muajit tetor.

"Dardanët" kanë rënë për katër pozita dhe tash janë në vendin e 113-të. Kosova pësoi humbje nga Suedia dhe Gjeorgjia në ndeshjet kualifikuese për Kupën e Botës 2022. Ndërsa Shqipëria është ngritur për tri pozita në ranglistën botërore të ekipeve kombëtare të FIFA-s, pasi mposhti Hungarinë dhe pësoi humbje nga Polonia. Kuqezinjtë

tash janë në vendin e 63-të. E para në renditjen e re të FIFA-s janë Belgjika dhe Brazili. Ndërsa Franca ka kaluar në vendin e tretë, Italia në të katërtin dhe Anglia ka rënë në të pestin. Argjentina në vendin e gjashtë, Portugalia në të shtatin, Spanja në të tetin, Meksika në të nëntin dhe Danimarka mbyll top 10-shën.



Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

NYON, 21 TETOR - Liga e Kampionëve u rikthye këtë javë duke dhuruar një spektakël të vërtetë për sytë e tifozëve. Në 16 ndeshje spikatën shumë lojtarë, ndërsa UEFA ka publikuar edhe formacionin

më të mirë të javës. Në portë është gardiani i skuadrës së Lille, Gërbiç. Skuadra franceze arriti të barazonte 0-0 me Sevillen, në një ndeshje ku Gërbiç shkëlqeu duke ndaluar andaluzianët ta gjenin rrugën

e golit. Në mbrojtje janë zgjedhur dy lojtarë të Barcelonës, Jordi Alba dhe Gerard Pique, ndërsa reparti defensiv plotësohet nga Blind i Ajaxit dhe Coates i Sporting Lisbonës. Në mesfushë janë

zgjedhur Okafor i Salzburgut dhe Jorginho i Chelseat, ndërsa sulmi plotësohet nga Sane i Bayernit, Salah i Liverpoolit, Mahrez i Manchester Cityt dhe Vinicius i Realit.



Rrëfëhet Shima për karrierën e bujshme dhe pensionimin

PRISHTINË, 21 TETOR - Një nga basketbollistët më të dalluar shqiptar është Gerti Shima, i cili ka vendosur të pensionohet. Pas një karriere të bujshme, në Kosovë e Shqipëri, si dhe me kombëtaren kuqezi, shtatllarti shqiptar ka vendosur të largohet nga parketi. Ai ishte shumë i dashur për tifozët në Kosovë, ndërsa ishte pjesë e AS Prishtinës, Pejës, Bashkimit dhe Sigal Prishtinës. "I erdhi fundi një karriere të mrekullueshme, pas 21 vjetësh, e mbaj mend çdo detaj, që nga shënimi i parë me Tiranën në moshën 14 vjeç e, po ashtu, edhe me ndeshjen e parë ndërkombëtare ku takohej kampioni i Kosovës kundër kampionit të Shqipërisë. Në atë kohë luaja me Tiranën dhe ndeshja po zhvillohej në Mitrovicë më 2001 kundër Trepçës. Ka qenë një përvojë e bukur për 21 vjet. Tash jam inkuadruar në Komitetin Olimpik Shqiptar dhe po merrem me sport. Ende nuk po më mungon basketbolli (qesh). Kam dashur të mbyll karrierën në formë siç e kam bërë tani", është shprehur Shima



për faqen zyrtare të FBK-së. Ai foli për përvojën në Kosovë. "Kam qenë për gjashtë vjet në AS Prishtinë, Pejë, ku jemi shpallur kampionë me Dardanin (Berishën), Samirin (Sapthahoviq), si dhe bashkëlojtarët e tjerë, pastaj ishte kalimi në Bashkim, ku kam kaluar shumë mirë dhe, po ashtu, në Prishtinë, pavarësisht se në atë kohë u bë zhurmë, por sporti profesionist i ka këto. Kam krijuar gjëra të mira dhe më bëjnë të lidhur dhe kthehem me nostalgji dhe me shumë miq që më

presin në Kosovë", ka shtuar Shima. "Tifozët më kanë përkrahur gjithmonë, sepse në parket kam dhënë maksimumin. Shqiptonjat, Plisat dhe Arpagjikët me përvojën më të mirë në karrierën time, e kam pasur në Kosovë, pavarësisht se kam luajtur shumë edhe në Shqipëri. U jam falënderues të gjitha skuadrave ku kam luajtur dhe të gjithë sportdashësve", ka përfunduar Shima, i cili ka fituar shumë trofe në Kosovë dhe Shqipëri.

Fitojnë Utah dhe Spurs, bien Celticsi dhe Sunsi

Salt Lake City, 21 tetor - Utah Jazz e nisi me këmbën e mbarë sezonin e ri të NBA-s, duke triumfuar me shifrat 107-86 ndaj Oklahoma City Thunderit në Salt Lake City. Një fitore e thjeshtë për Utahn nën shenjën e dyshes Bojan Bogdandoviç - Jordan Clarkson të cilët të dy së bashku realizuan 40 pikë. Një duel i fituar që në pjesën e parë me Utahn që shkoi në pushim me avantazhin e 12 pikëve dhe më pas arriti të menaxhojë në mënyrë të përkryer ndeshjen. Fitore e thjeshtë edhe për San Antonio Spursin. Skuadra e Gregg Popovichit kaloi me shifrat e thella 123-97 Orlando Magicoun në AT&T Center në Texas në një ndeshje ku diferencën e bëri loja në grup e San Antonios me 7 basketbollistë të Spursit që arritën një kuotë pikësh me dy shifrat, me Vasell që ishte më i miri mbi parket me 19 pikë të realizuara. Ndeshje spektakolare ajo në mes të New



York Knicksit dhe Boston Celticsit që përfundoi pas dy kohëve shtesë me fitoren 138-134 të skuadrës nga Molla e Madhe. 46 pikë realizoi 24-vjeçari Jaylen Brown, të pamjaftueshme gjithsesi për ta evituar humbjen e 16 herë kampionëve të NBA-së, ndërkohë që te skuadra njujorkeze spikatën Julius Randle me 35 pikë dhe

francezi Evan Fournier me 32 pikë. Nënkampioni i NBA-s, Phoenix Sunsi, nuk e nisi mirë sezonin e ri pasi u mposht nga Denver Nuggets brenda në Arizona me rezultatin 110-98 në një sfidë që u vendos në periodën e fundit dhe hero i miqve ishte padiskutim serbi Nikola Jokiq me 27 pikë, 13 rebounde dhe 2 asistime.

SHKURT

Mbappe: Messi e meriton 'Topin e Artë'

Sulmuesi i Paris Saint-Germainit, Kylian Mbappe, ka mbështetur shokun e skuadrës, Lionel Messi, për ta fituar "Topin e Artë" të vitit 2021. "Është një privilegj të luash me të dhe do të ishte plotësisht e merituar nëse ai do të fitonte 'Topin e Artë'", ka thënë Mbappe. Ndryshe, sikurse Messi, ashtu edhe Mbappe gjenden në listën e ngushtë të France Football për "Topin e Artë" të vitit 2021.

Trajneri i Bayernit infektohet me Covid

Bayern Muncheni mori një tjetër fitore në Ligën e Kampionëve 4-0 në transfertën ndaj Benficës, por nuk ka aspak lajme të mira lidhur me trajnerin Julian Nagelsmann. Trajneri, në fakt, mbeti në hotel për shkak të asaj që ishte quajtur një "infeksion i ngjashëm me gripin" dhe në vend të tij në krye të ekipit ishin asistentët Dino Toppmoller dhe Xaver Zembrod. Të enjten, në fakt, klubi gjerman njoftoi atë që të gjithë kishin frikë, Julian Nagelsmann rezultoi pozitiv me koronavirus pavarësisht se ishte vaksinuar. Ai do të kthehet në Mynih veçmas nga ekipi, me një avion ambulancë dhe do të vendoset në izolim shtëpiak. Në dy ndeshjet e radhës, Bayerni do t'i zhvillojë pa trajnerin e saj dhe sërish asistentët do ta drejtojnë skuadrën në fushë.

Buffon: Nuk mendoj për tërheqjen nga futbollit

Gigi Buffoni, në një intervistë me "Prime Video", ka thënë se nuk është duke menduar për pensionim nga futbollit. Portieri 43-vjeçar gjatë verës është transferuar nga Juventusit te Parma, ku është paraqitur në shtatë ndeshje. "Unë nuk mendoj për datën e daljes në pension (tërheqjes nga futbollit i luajtur). Dhe jam i sinqertë, në kuptimin që, veçanërisht në një vit e gjysmë ose dy të fundit, po jetoj në një gjendje të mirë fizike dhe mendore. Kësisoj, stërvitja dhe gjërat e tjera lidhur me fushën e blertë janë të lehta për mua, si 10 apo 15 vjet më parë", ka thënë Buffoni.

Rossi: Dua ta mbyll karrierën me një podium

Piloti italian Valentino Rossi u shpreh se në tri garat e fundit të këtij sezoni të fundit edhe të karrierës së tij në Moto GP dëshiron të bëjë një paraqitje të mirë. Pse jo, të synojë podiumin edhe pse ky duket një "mision i pamundur". "Pas disa garave jashtë Evropës tani jemi më të qetë dhe kam pasur mundësi të përgatitem më mirë. Gjatë këtyre ditëve jam stërvitur fort, në mënyrë që këto 3 gara të mbetura t'i përballoj në mënyrë më të mirë të mundshme nga ana fizike", ka thënë Rossi. "Synoj që në këto tri gara të shkojë sa më afër podiumit, në mënyrë që ta mbyll karrierën sa më mirë. Gara e radhës është në pistën e Misano, në shtëpinë time dhe dua ta shijoj në maksimum", u shpreh legjenda e Moto GP.

Ronaldo: 'Teatri i ëndrrave' është në flakë

Cristiano Ronaldo ka shënuar në tri ndeshje radhazi në Ligën e Kampionëve për Manchester Unitedin për herë të dytë në karrierën e tij duke e bërë fillimisht në nëntor 2007, në sezonin kur "Djajtë e kuq"

festuan trofeun. Pavarësisht një tjetër mbrëmjeje të vështirë, lojtarët treguan se janë me trajnerin Solskjaer duke larguar disi presionin mbi norvegjezin. "Po! 'Teatri i Ëndrrave' është në flakë! Ne

jemi gjallë! Ne jemi Manchester Unitedi dhe nuk dorëzohemi kurrë! Ky është 'Old Trafford', ka thënë sulmuesi portugez në "Instagram" pas fitores kundër Atalantës. "Nëse dikush do që

ta kritikojë atë për punën dhe sjelljen e tij, le të shohë këtë ndeshje dhe të shikojë se si ai vrapon përreth. Tifozët janë një pjesë shumë e madhe e këtij klubi. Sektori i korit e mbajti gjallë besimin e lojtarëve. Kjo

është ajo që ti bën tek Unitedi gjatë një mbrëmjeje të Ligës së Kampionëve. Ai kënd në këtë stadium është më i miri në botë. Unë mendoj se edhe në pjesën e parë ne luajtëm mirë", ka shtuar Ronaldo.

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Bilanci i gjendjes me : 30.09.2021		Euro'000
Pasurite	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	6,637	9,461
Kërkesat ndaj bankave	944	982
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	7,005	7,013
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	60,521	64,517
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,870	1,787
Pasuritë e paprekshme	240	222
Pasuritë tatimore të shtyra	38	38
Pasuritë tjera	249	166
Gjithsej pasuritë	77,504	84,186
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	58,600	61,770
Detyrimet ndaj bankave	4,131	4,130
Fondet tjera të huazuara	4,504	8,017
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	1,199	973
Gjithsej detyrimet	68,435	74,890
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	10,000	10,000
Rezervat e kapitalit		
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprak	1,236	1,068
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	299	357
Përbërësit tjerë të ekuitetit	7	7
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	9,069	9,296
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti	77,504	84,186

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.09.2021		Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	2,272	3,230
Shpenzimet e interesit	634	1,012
Neto të hyrat nga interesi	1,638	2,218
Të hyrat nga tarifet dhe komisionet	254	391
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	79	122
Neto të hyrat nga tarifet dhe komisionet	175	269
Neto të hyrat nga tregtimi	3	6
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	0	0
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	871	1,358
Gjithsej të hyrat	945	1,135
Provizionet për humbjet nga kreditë	630	770
Provizionet tjera	17	8
Fitimi/(humbja) para tatimit	299	357
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Shpenzimet e tatimit të shtyer	-	-
Fitimi/(humbja) neto	299	357
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	299	357

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

CV

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fton Mahmutaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Yll Morina" nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Sedat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike " Nexhmedin Nixha" Konfeksion.
- Bernardina Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" drejtimi Farmaci Gjakovë.
- Xhevdet Dervishaj nga Nasheci i Prizrenit, shpall të pavlefshme Diplomën e studimeve themelore universitare të lëshuar nga Kolegji "Dardania", drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

12 vite pa më të dashurën tonë

Naile Shpati

(17.05.1965 - 22.10.2009)



Shumë ditë kanë kaluar prej ditës së ikjes tënde, e të shumta janë gëzimet dhe takimet ku mungon prezenca jote.

Vitet nuk janë të njëjta pa ty, mungesa jote është e papërshkrueshme dhe e pa zëvendësueshme.

Dashuria le kujtim e kujtimi për ty nuk do të shuhet asnjëherë.

E përkujtojnë bashkëshorti: Dini me fëmijët Shendriti, Anita, Arbenita dhe Eronita.

Sot 12 vite pa ty

Naile Shpati

(17.05.1965 - 22.10.2009)



Vitet po ikin por kujtimi për ty është ende i freskët. Na mësove gjithmonë për gjithçka, por asnjëherë nuk na mësove të jetojmë jetën pa ty.

Të kujton përherë me mall: halla Shehrija me fëmijët.



ROYAL CROWN;
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales